



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË



Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • **Tel:** ++355 4 222230; 222750; 235568
• **Fax:** ++355 4 223558 • **Website** www.bankofalbania.org • **E-mail:** public@bankofalbania.org

14.07.2006

DEKLARATË PËR SHTYP

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë për tremujorin e parë të vitit 2006

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2006 rezultoi me një tepriçë prej 15.6 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit kanë përballuar rreth 56 për qind të deficitit korent dhe kanë çuar në rritjen e rezervës së autoritetit monetar.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Thellim i ndjeshëm i deficitit tregtar dhe i atij korent.
- Rritje e konsiderueshme e dërgesave nga emigrantët.
- Rritje e dukshme e mjeteve financiare në formën e depozitave tona jashtë.
- Rritje e mjeteve të rezervës së autoritetit monetar.

I. Llogaria korente

Vëllimi i transaksioneve korente është rritur me 26.8 për qind krahasuar me tremujorin e parë 2005, duke shënuar një nivel prej 1.6 miliardë eurosh. Mëse 95 për qind e shpenzimeve korente kanë shkuar për importe mallrash dhe shërbimesh, ndërkohë që eksporti i mallrave dhe ai i

shërbimeve ka siguruar rreth 60 për qind të të ardhurave.

Të ardhurat faktoriale neto janë rritur me rreth 52 për qind krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2005, megjithatë nuk kanë mundur të zbusin deficitin e lartë tregtar. Ky i fundit u zbut pjesërisht nga transfertat korente kryesisht nga të ardhurat nga emigrantët. Kontributi i këtyre dërgesave në zbutjen e deficitit tregtar llogaritet në rreth 54 për qind.

Si rezultat i këtyre lëvizjeve, llogaria korente u mbyll me një deficit prej 164 milionë eurosh, i cili vlerësohet të jetë 1.8 herë më i lartë se ai i një viti më parë.

I. 1. Tregtia e jashtme.

Ky vit nis me vëllime të larta të shkëmbimeve tregtare dhe për pasojë, me thellim të mëtejshëm të deficitit tregtar. Në terma absolutë, vëllimi i përgjithshëm tregtar, në fund të tremujorit të parë të vitit 2006 arriti 660 mln euro, duke qenë kështu 27 për qind më i lartë se ai i periudhës korresponduese të një viti më parë. Ndërkohë që tërheq vëmendjen përkeqësimi i ndjeshëm i bilancit negativ me 34 për qind, si pasojë e rritjes prej 29 për qind të importeve dhe 19 për qind të eksporteve.

Orientimi i theksuar drejt importeve, ka bërë që ato t'i tejkalojnë eksportet afërsisht 4 herë. Pikërisht tendenca në rrije e çmimeve të mallrave si nafta, makineri e pajisje, mjete transporti e produkte farmaceutike, ka shkaktuar shtim të shpenzimeve për importe. Në fund të këtij tremujori ato shënuan afërsisht vlerën 535 milionë euro ose rreth 121 milionë euro më shumë, krahasuar me vitin 2005. Të ardhurat nga eksporti i mallrave u rritën me 23 milionë euro, duke arritur në 144 milionë euro.

Natyrisht, kjo rritje shpreh edhe luhatjet që ka pësuar monedha evropiane gjatë periudhave korresponduese, pikërisht zhvlerësimin e saj prej 3 për qind.

Sipas një disagregimi në harmoni me sistemin e llogarive kombëtare, mallrat e ndërmjetëm zënë pothuajse gjysmën e importeve (47 për qind), ndërkohë që mallrat kapitalë dhe ata të konsumit kanë pësuar rënie të lehtë duke pasur përkatësisht këto nivele përfaqësimi (11 për qind dhe 30 për qind).

Industria e përpunimit në vend vazhdon të jetë përcaktuese në marrëdhëniet tona tregtare me botën. Importet e lëndës së parë zunë 15 për qind të totalit të tyre, ndërkohë 70 për qind e të ardhurave nga eksportet ishin kontribut i rieksporteve. Artikujt tekstilë dhe veshjet e këmbëve, që përfaqësojnë gati 80 për qind të totalit të eksporteve, gjatë këtij tremujori kanë pësuar një rënie të

lehtë prej 2 për qind, rezultat ky i ngadalësimit të ritmeve të kësaj industrie, për shkak të konkurrencës së mallrave kinezë. Megjithatë, depërtimi i ndjeshëm i tyre në tregun shqiptar duket se ka ngadalësuar ritmet e rritjes, krahasuar me bumin që ndodhi një vit më parë.

BE, partneri kryesor i vendit tonë, mban të njëjtat nivele përfaqësimi në totalin e transaksioneve tona tregtare (65 për qind). Italia dhe Greqia mbeten partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë dhe përfaqësojnë 83 për qind në eksporte dhe 46 për qind në importe. Gjithashtu, vërejmë një tendencë në rritje të importeve nga vendet e rajonit, të cilat gjatë këtij tremujori u rritën me 50 për qind. Ndërkohë, ngadalësim të ndjeshëm ka pësuar rritja e eksporteve drejt tregjeve rajonale, 6.6 për qind.

I. 2. Zhvillimet në zërat e tjerë të llogarisë korente.

Bilanci i tregtisë së shërbimeve u mbyll me një bilanc negativ prej 37 milionë eurosh, konsiderueshëm në rritje kundrejt deficitit prej 24 milionë, regjistruar në tremujorin e parë të vitit 2005. Ky deficit ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së importit të shërbimeve të transportit dhe atyre të biznesit.

Është tashmë e ditur se shërbimet e transportit dhe të sigurimeve ndjekin zhvillimet e aktivitetit tregtar të mallrave. Rritja e importit ka shkaktuar rritjen e importit të shërbimeve të këtyre kategorive. Kështu, në fund kësaj periudhe importi i shërbimeve të transportit dhe ai i sigurimit të mallrave, vlerësohen respektivisht 28.1 dhe 30 për qind më të lartë se ata të periudhës korresponduese të një viti më parë.

Vëllimi i transaksioneve në shërbimet e udhëtimit përfaqëson 68 për qind të vëllimit total në tregtinë e shërbimeve. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, në fund të këtij tremujori turizmi u mbyll me një suficit prej 12 milionë eurosh, kundrejt atij prej 5 milionë eurosh në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja në shpenzimet e udhëtarëve shqiptarë jashtë është dukshëm më ulët sesa rritja në të ardhura, duke shkaktuar rritjen e bilancit pozitiv të kësaj kategorie.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2006, eksporti i turizmit ka gjeneruar rreth 199 milionë euro të ardhura ose 38 për qind të ardhura më shumë se sa eksporti i mallrave.

Ky tremujor është karakterizuar kryesisht nga turizmi për qëllime personale se sa për qëllime biznesi. Kjo vihet re edhe në numrin e shtetasve që hyjnë dhe dalin gjithashtu dhe në shpenzimet e kryera prej tyre. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2006, numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë është rritur me 18 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin e

kaluar. Sipas vlerësimeve të këtij tremujori, një turist i huaj ka shpenzuar 30 për qind më shumë në krahasim me një vit më parë. Ndërkohë, vazhdojnë të vlerësohen në rritje shpenzimet për turizëm (me 30 për qind). Rezidentët shqiptarë kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 187 milionë euro ose sa 94 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët. Kjo rritje e shpenzimeve ka ardhur si pasojë e rritjes prej 14 për qind të numrit të shqiptarëve që kanë udhëtuar jashtë vendit, ndërsa shpenzimet ditore kanë ruajtur të njëjtin nivel me tremujorin e parë të vitit të kaluar.

Të ardhurat neto vlerësohen pozitive, të rritura me 52 për qind kundrejt periudhës korresponduese të vitit 2005. Edhe këtë tremujor ekonomia shqiptare ka përfituar burime valutore, të ardhura nga puna jashtë si dhe nga investimet e rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente, duke paguar njëkohësisht interesa për borxhin e jashtëm. Të ardhurat nga puna, përfaqësojnë rreth 47 për qind të të ardhurave hyrëse dhe vlerësohen me një rritje 34 për qind kundrejt tremujorit korrespondues të vitit të kaluar. Gjithashtu, rritje prej 50 për qind kanë pësuar edhe të ardhurat në formën e normës së kthimit të investimeve tona jashtë.

Ndërkohë, rreth 86 për qind e të ardhurave dalëse përfaqësohen kryesisht nga interesat e borxhit të jashtëm dhe të investimeve të rezervave të bankave jorezidente në sistemin tonë bankar.

Transfertat korente, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara, kanë marrë formë prej prurjeve nga emigrantët. Këto të fundit përfaqësojnë një burim të rëndësishëm mbështetës për ekonominë shqiptare, duke siguruar një fluks të vazhdueshëm financimi për deficitin korent. Totali i dërgesave nga emigrantët, për tremujorin e parë 2006 vlerësohet të jetë rreth 199.6 milionë euro dhe përfaqësojnë 10.9 për qind të PBB-së.

II. Llogaria kapitale dhe financiare

Lëvizjet e kapitalit, gjatë këtij tremujori, rezultuan në një fluks neto prej rreth 92 milionë eurosh, duke mundësuar financimin e deficitit korent me rreth 56 për qind. Transfertat kapitale shënojnë 36 milionë euro, ndërkohë që, llogaria financiare u mbyll me një bilanc pozitiv prej rreth 56 milionë eurosh.

Pozicioni i llogarisë financiare këtë tremujor përkufizohet në rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 92 milionë euro) si dhe rritje të mjeteve tona jashtë (rreth 36 milionë euro). Krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar, fluksi neto i detyrimeve financiare vlerësohet të jetë 46 për qind më i lartë. Ndërkohë, pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës kanë ruajtur të njëjtin nivel të një viti më parë.

Detyrimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me rreth 92 milionë euro dhe vlerësohen të jenë 46 për qind më të larta se ato të së njëjtës periudhë të një viti më parë. Kjo rritje i dedikohet flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte si dhe të borxhit të jashtëm.

Fluksi i investimeve të huaja direkte arriti vlerën 56.7 milionë euro kundrejt 45 milionë eurove realizuar në vitin e kaluar. Duhet përmendur që këtë fillimviti, kanë qenë flukset hyrëse të kapitalit në fushën industrisë përpunuese dhe të asaj prodhuese, që kanë luajtur rolin kryesor në këto investime. Lëvrimet e kredive afatgjata dhe atyre të buta nga jashtë, të cilat mbeten një faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës, gjatë këtij viti vlerësohen 36 milionë euro. Kjo rritje ka financuar kryesisht investimet dhe konsumin, gjë që u reflektua edhe në rritjen e importeve për konsum si dhe nevojat për kapital dhe mallra kapitale të kompanive. Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 15.5 milionë euro, të barasvlershme me 11 për qind të eksportit të mallrave.

Pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur në 36 milionë euro. Rritja e këtyre mjeteve financiare vjen kryesisht nga investimet e rezervave të sistemit bankar në tregun ndërkombëtar, në formën e depozitave të cilat ndryshe nga rënia prej 7 milionë eurosh në vitin e kaluar, janë rritur me 57 milionë euro. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e zhvendosjes së investimeve të sektorit tonë bankar, nga tregu i brendshëm në tregjet e huaja financiare. Ndërkohë, investimet e portofolit paraqiten në rënie prej 4.6 milionë eurosh kundrejt një rritjeje prej 43 milionë, të të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 15.6 milionë euro. Rezerva valutore në fund të tremujorit të parë të vitit 2006 shënoi nivelin 1.214 miliardë euro, i mjaftueshëm për të mbuluar rreth 4.5 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

Bilanci i Pagesave

Ne milione euro

	3M-I 2005	3M-I 2006
Llogaria korrente	-90.2	-164.3
	0.0	0.0
Eksporti i mallrave	121.5	144.4
Importii mallrave	-398.1	-515.2
Bilanci Tregtar	-276.6	-370.8
Sherbimet: Kredi	203.8	267.3
Sherbimet: Debi	-227.9	-303.8
Te ardhurat: Kredi	36.9	52.4
Te ardhurat: Debi	-9.1	-10.1
Transferta private pa shperblim	170.9	184.6
Tranferta shteterore pa shperblim	11.8	16.2
Llogaria kapitale	35.5	36.0
Llogaria financiare	29.7	55.9
Investime direkte	43.3	56.7
Investime portofoli	-42.8	4.6
Kapitale te tjera*	24.6	-8.4
Gabime dhe harresa neto	34.6	88.1
Bilanci i Pergjithshem	9.7	15.6
Rezervat dhe zera te lidhur me to		
Mjetet e Rezerves	-9.7	-15.6
Perdorim huash e kredish nga FMN	4.6	2.9
Per t'u mbajtur ne vemendje		
Ndryshimi total ne rezerva	7.8	10.4
nga te cilat: Ndryshim nga kursi i kembimit	0.4	-5.2

*/ Nuk perfshihen perdorime huash e kredish nga FMN

Burimi: Banka e Shqiperise